

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD

AUDIT | TAX | CONSULTING

RAPORTI I TRANSPARENCËS 2022

RSM Albania shpk

The Power of Being Understood

PËRMBAJTJA

MESAZH NGA PARTNERI DREJTUES	i
RRETH RSM ALBANIA	1
Struktura ligjore, pronësia dhe drejtimi	2
RRJETI GLOBAL RSM	2
RSM Orb-Metodologjia e auditimit	4
Struktura Globale e RSM	4
SISTEMET E KONTROLLIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË	5
Qeverisja dhe drejtimi	5
Pranimi/vazhdimi i klientit	6
Etika dhe politikat e pavarësisë	7
RSM InTrust	8
Burimet njerëzore	8
Kualifikimi i vijueshëm profesional	9
Performanca e Angazhimit	9
Mbikëqyrja dhe rishikimi	10
Aktivitetet për vlerësimin dhe monitorimin e cilësisë	11
Konsultimet	11
DEKLARATA E PAVARËSISË	12
INFORMACION FINANCIAR	12
SHPËRBLIMI I PARTNERËVE	12
LISTA E NJËSIVE ME INTERES PUBLIK (NIP)	12

MESAZH NGA PARTNERI DREJTUES

Ne kemi kënaqësinë të prezantojmë Raportin e Transparancës për RSM Albania për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 10 091, datë 5.03.2009, "Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar".

Ky ka qenë viti ynë i parë ku ne operojmë si pjesë e një rrjeti ndërkombëtar me reputacion të shkëlqyer si RSM International. Në RSM Albania, ne krenohemi me ekipin tonë i cili drejtohet nga partnerë me përvojë 20 vjecare. Kjo përvojë ka qenë shpërblyese, depërtuese dhe e njohur për tregun Shqiptar.

Partnerët dhe profesionistët e RSM Albania kanë një përvojë të konsiderueshme në ofrimin e një game të gjerë shërbimesh profesionale në disa sektorë dhe industri vendase.

Ne jemi të përkushtuar t'u ofrojmë klientëve tanë shërbime të një cilësie të lartë lidhur me aspektet kryesore të mëposhtme:

- Një ekip dhe nje partner të dedikuar për cdo linjë shërbimi
- Shërbime me cilësi të lartë, të integruara dhe innovative
- Njohuri të thella të sektoreve dhe industrive për shërbimet e ofruara

RSM dallon përmes një përvoje thellësisht të personalizuar dhe të pasur që ngjall besim te klienti, dhe shfrytëzon njohuritë kolektive globale dhe kapacitetet teknologjike.

Synimi ynë është që të shihemi si lider në tregun e punës, nën kornizën e një marke të njohur globalisht që promovon qëndrueshmërinë tek njerëzit tanë.

Reputacioni ynë është ndërtuar mbi njohuritë tona të thella për tregun vendas, njohuritë tona profesionale për zbatimin e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit, kuadrin rregullator lokal dhe ndërkombëtar dhe të gjithë spektrin e rrezikut.

Në RSM, qëllimi ynë është për të ngjallur besim tek bota e ndryshimit. Organizata jonë shumë e ndërlidhur përqafton ndryshimin dhe rritet me ritëm të shpejtë. Ne ofrojmë një përgjigje bashkëpunuese dhe të shpejtë ndaj nevojave të klientit bazuar në të kuptuarit e thellë dhe të inovacionit digjital.

Në një botë komplekse dhe të pasigurtë, ndryshimi është i pashmangshëm dhe i domosdoshëm. Ne ekzistojmë për të fuqizuar klientët dhe njerëzit tanë për të ardhmen dhe t'u japim atyre besimin për të marrë përgjegjësinë e ndryshimit.

Bujar Bendo
Partneri Drejtues

RSM Albania Sh.p.k

Rr. Skender Luarasi, sheshi Gjenerali Jozef San Martin, Pallati 3, Hyrja 19, 1000 Tirana, Republic of Albania


DL: +355 69 20 90030 | E: bujar.bendo@rsm.al | Web: www.rsm.global/albania

RRETH RSM ALBANIA

Shoqëria RSM Albania shpk¹, në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 10 091, datë 5.03.2009, “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar”, i ndryshuar, neni 45, prezanton në vijim Raportin e Transparencës. Informacioni i prezantuar në këtë raport i përket vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2022. RSM Albania është pjesë e rrjetit të Firmave Anëtare të RSM International, e krijuar dhe e regjistruar në vitin 2019, me seli në Tiranë, Shqipëri.

Ne ofrojmë një gamë të gjerë shërbimesh si:

- Auditimi dhe shërbime të dhënies së sigurisë
- Shërbime kontabiliteti dhe konsulence fiskale
- Shërbimet e këshillimeve financiare të biznesit



Me profesionistë me përvojë dhe mbështetje nga burimet e RSM International, RSM Albania sigurohet që të ofrojë:

- Shërbime të standardeve më të larta
- Përdorimin e metodologjive dhe praktikave më të mira
- Përpjekje maksimale për të tejkaluar pritshmëritë
- Shërbimet e duhura në mënyrë etike dhe të pavarur
- Ndërtojë marrëdhënie të besueshme
- Zhvilloje aftësitë e njerëzve në mënyrën më të mirë të mundshme
- Cilësinë e markës që përfaqëson
- Kontribut në komunitetin tonë

Si një nga firmat lider të shërbimeve profesionale, ne tërheqim profesionistë të nivelit të lartë, të cilët me trajnimin e duhur dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional janë të aftë të performojnë sipas standardeve të larta të firmës sonë. Kapaciteti ynë i burimeve në fushat kryesore me rëndësi për klientët tanë është përmirësuar dhe ne vazhdojmë të shtojmë aftësi dhe disiplinë të reja që na mundësojnë të bëjmë një punë edhe më të mirë për t'u shtuar vlerë klientëve tanë. Me kulturë të larmishme dhe gjithëpërfshirëse, ne synojmë të vendosim një model për të tjerët duke vënë në pah vlerat tona kryesore, integritetin, respektin dhe përkushtimin ndaj njerëzve tanë, punën në ekip dhe bashkëpunimin.

¹ Për më shumë informacion rreth RSM vizitoni faqen zyrtare: www.rsm.global/albania

Struktura ligjore, pronësia dhe drejtimi

RSM Albania shpk është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar dhe organizuar sipas legjislacionit shqiptar, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në datën 13/11/2019, me numër unik identifikimi (NUIS) L92313035V dhe adresë në Rruga Skender Luarasi, sheshi Gjenerali Jozef San Martin, Pallati 3, Hyrja 19, Tiranë.

RSM Albania është anëtare e Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar, (IEKA) dhe anëtare e rrjetit ndërkombëtar RSM International.

Administratorë të shoqërisë janë Z.Bujar Bendo dhe Zj.Elona Bisha.

Drejtimi i shoqërisë kryhet nga bordi i partnerëve dhe partneri manaxhues Z.Bujar Bendo.

RRJETI GLOBAL RSM

RSM Albania është pjesë e rrjetit të Firmave Anëtare RSM International. RSM International është marka e përdorur nga një rrjet firmash të pavarura kontabiliteti, auditimi dhe konsulence. Çdo anëtar i rrjetit është një firmë ligjërisht e veçantë dhe e pavarur. Marka është në pronësi të rrjetit Ndërkombëtar RSM. Rrjeti manaxhohet nga RSM International Limited.

As RSM International Limited dhe as RSM International Association nuk ofrojnë shërbime kontabiliteti ose konsulence. Rrjeti që përdor markën RSM International nuk është në vetvete një ent juridik i veçantë i ndonjë përshkrimi në asnjë juridiksion.

Çdo firmë anëtare dhe firmë korrespondente është e pavarur dhe është përgjegjëse për detyrimet e veta. Vetëm firmat anëtare të RSM International konsiderohen anëtare të plota të Forumit të Firmave përmes statusit të tyre anëtar në RSM International.



Ortakë të shoqërisë RSM Albania shpk, janë:

- Z.Bujar Bendo, i cili zotëron 45%, të kapitalit të shoqërisë
- Zj.Fatbardha Shtrepi, e cila zotëron 25%, të kapitalit të shoqërisë
- Zj.Elona Bisha, e cila zotëron 25%, të kapitalit të shoqërisë
- Z.Sadik Berisha, i cili zotëron 5%, të kapitalit të shoqërisë

Një firmë anëtare pranon të përmbushë një sërë standardesh të larta të vendosura nga Bordi Ndërkombëtar i Drejtorëve të RSM International. Këto standarde lidhen me cilësinë dhe gamën e shërbimeve të tyre, si dhe me çështje të tjera si madhësia, vendndodhja dhe marka e tyre. Firmat anëtare bien dakord të zbatojnë politika globale për sigurimin e cilësisë, auditimin, etikën dhe pavarësinë dhe inspektimet, në përputhje me standardet ndërkombëtare të zbatueshme.

Firmat anëtare plotësojnë një program vjetor të inspektimit të brendshëm, i cili i nënshtrohet një rishikimi të brendshëm të sigurimit të cilësisë të koordinuar globalisht të paktën çdo tre vjet.

Firmat anëtare të RSM udhëhiqen nga një vizion i përbashkët i ofrimit të shërbimeve profesionale me cilësi të lartë si në tregun e tyre vendas ashtu edhe në atë ndërkombëtar në shërbim të nevojave të klientëve të tyre.

Rrjeti RSM lidh firmat anëtare përmes metodave dhe proceseve të përbashkëta, duke përfshirë standardet e cilësisë të miratuara dhe të aplikuara në mënyrë universale.

Këto lidhje u mundësojnë partnerëve dhe stafit të firmave anëtare RSM të ofrojnë standarde të larta shërbimi dhe këshillash për klientët – kudo në botë.




Në RSM, ne i ndihmojmë klientët të kapërcejnë sfidat e reja, të përqafojnë ndryshimin dhe të përshtaten për tu rritur.

Duke punuar së bashku, duke krijuar njohuri të thella, duke kombinuar teknologjinë e klasit botëror dhe përvojën e botës reale, ne ofrojmë kuptim të pakrahasueshëm dhe besim ku mund të mbeshteten. **Për një botë në ndryshim. Për të ardhmen. Për të gjithë.**

RSM është një rrjet i fuqishëm ekspertësh auditimi, taksash dhe këshillimi me zyra në të gjithë botën. Si një ekip i integruar, ne ndajmë aftësitë, njohuritë dhe burimet, si dhe një qasje të qëndrueshme të klienti që bazohet në një kuptim të thellë të biznesit të tij. **Kjo është mënyra se si ne ju fuqizojmë të ecni përpara me besim dhe të realizoni potencialin tuaj të plotë.**

Të përqëndruar në tejkalimin e pritshmërive-Në RSM, ne besojmë në dhënien më shumë klientëve: Më shumë mirëkuptim. Më shumë ekspertizë. Më shumë besim.




RSM Orb-Metodologjia e auditimit

Zyra Globale Ekzekutive (GEO) me qëllim mbështjen e firmave anëtare për kryerjen e auditimeve me cilësi të lartë, ka zhvilluar RSM Orb, zgjidhjen e auditimit të bazuar në risk të RSM-së. RSM ORB ka në përberje të saj Metodologjinë globale të auditimit, Manualin global të auditimit, modelet e RSM-së të vendosura në programin e auditimit Caseware dhe udhëzimet. Në përputhje me kërkesat e rrjetit RSM Albania përdor RSM Orb për të gjitha angazhimet e auditimit.

RSM Orb përfshin kërkesat për rishikimet e kontrollit të cilësisë së angazhimit dhe konsultimet e detyrueshme me drejtuesin e auditimit, drejtuesin e etikës dhe pavarësisë ose një partner tjetër të kualifikuar, sipas rastit. RSM Orb përputhet me kërkesat e mëposhtme:

- Standardin Ndërkombëtar për Kontrollin e Cilësisë, i publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe të Sigurisë (BSNAS)
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të publikuara nga BSNAS
- Deklaratat e praktikës ndërkombëtare të auditimit të lëshuara nga BSNAS
- Sigurimi i cilësisë së RSM dhe politikat e kontrollit të rrezikut



Struktura Globale e RSM

Struktura globale e RSM synon në thelb ekzekutimin e strategjisë globale të RSM dhe mundëson zhvillimin e biznesit nëpër firmat anëtare.

Disa fakte rreth Rrjetit Global RSM:



E pranishme në 120 vende, me një ekip global prej më shumë se 57,000 personash dhe mbi 830 zyra nëpër Amerikë, Evropë, Afrikë dhe Azi Paqësor.

Për më shumë informacion rreth RSM vizitoni faqen zyrtare: www.rsm.global

SISTEMET E KONTROLLIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË

RSM Albania operon sipas politikave dhe procedurave që promovojnë një kulturë të brendshme dhe bazohen në faktin se cilësia është thelbësore në kryerjen e angazhimeve.

RSM Albania ka adaptuar politika dhe procedura për sigurimin e cilësisë dhe adresimit të rrezikut. Sistemet e kontrollit të cilësisë janë krijuar për të dhënë sigurinë e arsyeshme që firma dhe personeli i saj veprojnë në pajtim me standardet profesionale dhe kërkesat e zbatueshme ligjore e rregullatore dhe raportet e lëshuara nga firma dhe partnerët e angazhimit janë të përshtatshme për rrethanat.

Sistemi i kontrollit të cilësisë, përmban politika dhe procedura, mbi përgjegjesinë e drejtimit dhe qeverisjes për sistemin e kontrollit të cilësisë së

Qeverisja dhe drejtimi

RSM Albania ka krijuar një mjedis me objektivat e mëposhtme të cilësisë:

- Një përkushtim i dukshëm ndaj cilësisë nëpërmjet një kulture që ekziston në të gjithë RSM Albania
- Kërkesa për të kryer vazhdimisht angazhime cilësore dhe për shërbimet e kryera sipas Standardeve të Angazhimit të IAASB, duke njohur rolin e RSM Albania në shërbim të interesit publik;
- Rëndësia e etikës, vlerave dhe qëndrimeve profesionale;
- Përgjegjësia e të gjithë personelit për cilësinë në kryerjen e angazhimeve ose aktiviteteve brenda sistemit të manaxhimit të cilësisë dhe sjelljen e pritshme të tyre; dhe
- Rëndësia e cilësisë në vendimet dhe veprimet strategjike të RSM Albania, duke përfshirë prioritetet financiare dhe operacionale të saj;

firmës, pranimin e klientit, rivlerësimin për vazhdimin e klientit, planifikimin e angazhimit, kryerjen e angazhimit dhe dokumentimin, mbikqyrjen dhe rishikimin, etikën dhe pavarësinë, punësimin dhe rekrutimin, trajnimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional, monitorimin dhe inspektimin.

Shoqëria ka kryer angazhimet e vitit 2022 në përputhje me kërkesat e Standardit Ndërkombëtar për Kontrollin e Cilësisë (ISQC) 1, "Kontrolli i cilësisë për firmat që kryejnë auditime dhe rishikime të informacioneve financiare historike dhe angazhime të tjera të sigurisë e të shërbimeve të lidhura".

Nga data 15 dhjetor 2022, shoqëria ka implementuar dhe aplikuar Standartin Ndërkombëtar për Manaxhimin e Cilësisë. (ISQM1).

- Drejtimi i Shoqërisë është përgjegjës dhe i përgjegjshëm për cilësinë;



- Drejtimi tregon një përkushtim ndaj cilësisë përmes veprimeve dhe sjelljeve të tij;
- Struktura organizative dhe caktimi i roleve, përgjegjësi dhe autoritetit është i përshtatshëm për të mundësuar hartimin,

zbatimin dhe funksionimin e sistemit të manaxhimit të cilësisë së RSM Albania;

- Nevojat për burime, duke përfshirë burimet financiare, teknologjike dhe intelektuale, planifikohen dhe burimet merren, shpërndahen, caktohen ose përdoren në një mënyrë që është në përputhje me angazhimin e RSM Albania për cilësinë. Burimet e tilla intelektuale duhet të jenë gjithashtu në

Pranimi/vazhdimi i klientit

Në RSM Albania, me qëllimin e ofrimit të shërbimeve të sigurisë me cilësi të lartë pranohen ata klientë të cilët ndajnë vlerat dhe besimet thelbësore të RSM Albania, të cilët plotësojnë kriteret kryesore të pranimit të RSM dhe janë të përgatitur të paguajnë një tarifë të drejtë për punë cilësore.

RSM Albania angazhohet me klientë, të cilët plotësojnë kriteret kryesore të pranimit:

- Klientë që veprojnë me integritet, në përputhje me ligjet dhe rregullat e aplikueshme, përfshirë kërkesat e parandalimit të financimit të terrorizmit dhe pastrimit të parave.
- Në pranimin e klientit zbatohen politikat e etikës dhe pavarësisë, dhe cdo klient i cili është i ndaluar nga këto politika refuzohet.
- RSM Albania kupton nevojat dhe kërkesat e klientit për shërbimet e kërkuara.
- RSM Albania ka në dispozicion aftësitë e nevojshme, përfshirë burimet dhe ekspertizën e mjaftueshme, për të kryer punën e kërkuar nga klienti dhe për të dhënë raportet e nevojshme dhe materiale të tjera brenda kornizës kohore të raportimit.

përputhje me standardet e aplikueshme profesionale dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore; dhe

- Burimet njerëzore, teknologjike ose intelektuale nga ofruesit e shërbimeve janë të përshtatshme për t'u përdorur në sistemin e menaxhimit të cilësisë së RSM Albania dhe në kryerjen e angazhimeve.



Gjatë procesit të pranimit të klientit, partneri që do të angazhohet, vlerëson gjithashtu nivelin e rrezikut të angazhimit dhe përcakton nëse përmbushen kërkesa për personel të specializuar, mbikëqyrje dhe rishikim. Një partner i dytë caktohet të dakordësojë arritjen e përfundimit për të pranuar një angazhim ose një marrëdhënie me klientin që plotëson profile të caktuara rreziku.

Etika dhe politikat e pavarësisë

Si pjesë e rrjetit RSM Global, RSM Albania adapton politikat e etikës dhe pavarësisë të rrjetit. Këto politika ndihmojnë për të siguruar që firmat anëtare, partnerët dhe punonjësit profesionistë të jenë në përputhje me pavarësinë dhe kërkesat etike të Bordit Ndërkombëtar të Standardeve të Etikës për Kontabilistët (IESBA) Kodi Ndërkombëtar i Etikës për Kontabilistët Profesionistë (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë).



Partnerëve dhe punonjësve, u kërkohet që cdo vit të plotësojnë formularin e përputhshmërisë së pavarësisë, duke konfirmuar që:

- kanë lexuar politikat e etikës dhe pavarësisë së rrjetit
- kanë lexuar politikat e etikës dhe pavarësisë së shoqërisë
- janë dhe kanë qenë dhe në periudhat e kaluara në përputhje me këto politika.
- kuptojnë aplikimin e këtyre politikave në aktivitetet e tyre

Në RSM Albania ne jemi të përkushtuar të ndërtojmë një reputacion për integritetin, cilësinë dhe përsoshmërinë e shërbimit ndaj klientit. **Vizioni ynë për të ardhmen është të bëhemi zgjedhja e parë si konsulent nga liderët e tregut të mesëm.** Për të arritur këtë objektiv, ne kërkojmë që punonjësit të jenë pranë klientëve dhe ti ofrojnë një përvojë që e dallon firmën tonë nga konkurrenca.

Në këtë kuader, kushdo që punon për RSM Albania duhet të veprojë me kujdes profesional për të mbrojtur reputacionin tonë dhe për të ofruar shërbimin në një mënyrë që është në përputhje me pritshmëritë që klientët dhe tregu kanë nga firma jonë.

Kodi ynë i sjelljes përshkruan standardet e sjelljes etike për të cilat ne mbajmë përgjegjes njëri-tjetrin. Ai bazohet në vlerat thelbësore të firmës sonë, të respektit, integritetit, punës në ekip, përsoshmërisë dhe drejtimit.

Partnerët e angazhimit dhe i gjithë stafi i shoqërisë RSM Albania, kanë përgjegjësinë personale për rishikimin periodik të përmbajtjes së Kodit IESBA dhe procedurave dhe politikave të brendshme.

Të gjithë partnerët dhe punonjësit e shoqërisë janë të vetëdijshëm dhe kuptojnë standardet ndërkombëtare të pavarësisë të Kodit IESBA dhe çdo kërkesë shtesë lokale. Politika e pavarësisë së firmës kërkon që të gjithë anëtarët e ekipit të angazhimit t'i plotësojnë këto kritere për të gjitha angazhimet e sigurisë dhe raportet e lëshuara.

RSM InTrust

RSM nga muaji prill 2022, ka implementuar RSM Intrust, një sistem i ri, i integruar global i pavarësisë, drejtimit të entitetit dhe autorizimit të shërbimit, për ruajtjen e kërkesave të etikës dhe pavarësisë. Ky sistem i ri, ka përmirësuar pavarësinë globale, duke

mundësuar marrjen e vendimeve në kohë dhe të bazuara në informacion, duke përmbushur kërkesat e rregullatorëve dhe të klientëve që janë në ndryshim të vazhdueshëm, përmes teknologjisë dhe proceseve të automatizuara.

Burimet njerëzore

Partneri kryesor i angazhimit sigurohet që ekipi i angazhimit të ketë ekspertizën, aftësinë dhe kohën e duhur për të kryer angazhimin në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat rregulatore ose ligjore të aplikueshme, për të mundësuar lëshimin e një raporti/prodakti të përshtatshëm sipas rrethanave. Caktimi i personelit në angazhime do të bazohet në konsiderimin adekuat të faktorëve të mëposhtëm:

- Kërkesat për personelin dhe kohën e angazhimeve;
- Njohuritë dhe kualifikimet teknike, përvojën dhe përvojën funksionale dhe industriale të nevojshme për kryerjen efektive të angazhimeve;
- Natyrën dhe shtrirjen e mbikëqyrjes dhe e përfshirjes nga personeli mbikëqyrës në angazhime;
- Mundësitë për zhvillimin e stafit në vendin e punës;
- Vazhdimësinë e personelit në angazhime;
- Angazhime të tjera të stafit të caktuar në angazhime; dhe
- Probleme të mundshme si pavarësia, konfliktet e interesit, kufizimet e udhëtimit dhe marrëdhëniet me klientët.



Personeli i caktuar në angazhim duhet të plotësojë çdo kërkesë trajnimi dhe kualifikimi profesional për nivelin e tyre, siç përcaktohet nga RSM Albania.

Partneri i angazhimit sigurohet që personeli i caktuar për secilin angazhim është i përshtatshëm në numer dhe cilësi dhe se çdo kërkesë e veçantë për personel është përmbushur.

Kualifikimi i vijueshëm profesional

Partnerët e angazhimit dhe të tjerë pjestarë me titullin Auditues Ligjor, kryejnë kualifikimin e vijueshem profesional, të organizuar nga IEKA. Partnerët dhe të gjithë punonjësit e RSM Albania, kryejnë trajnimet e përcaktuara sipas nivelit të pozicionit të tyre, për kualifikimin e vijueshëm profesional, në platforma, webinar etj, të rrjetit RSM Global, në bazë të nje plani vjetor. Ne investojmë kohë të mjaftueshme për të përmirësuar dhe rritur vazhdimisht aftësinë profesionale të stafit tonë, duke hartuar programe trajnimi në përputhje me pozicionin dhe nevojat për të mësuar, zhvilluar dhe

Performanca e Angazhimit

RSM Albania sigurohet që të gjitha angazhimet të kryhen në përputhje me standardet profesionale të zbatueshme dhe çdo kërkesë rregullatore dhe ligjore në lidhje me shërbimet që do të ofrohen.

Partneri i angazhimit merr përgjegjësinë e përgjithshme për drejtimin, mbikëqyrjen dhe kryerjen e angazhimit në emër të RSM Albania, në përputhje me standardet e aplikueshme profesionale, kërkesat rregullatore dhe ligjore, dhe për të siguruar që një raport i përshtatshëm është lëshuar ose parashikuar sipas rrethanave. Partnerët e angazhimit kanë gjithashtu përgjegjësi të përgjithshme për manaxhimin dhe arritjen e cilësisë në çdo angazhim në të cilin ata janë caktuar dhe do të përfshihen mjaftueshëm dhe në mënyrë të përshtatshme gjatë gjithë angazhimit. Përgjegjësitë e tyre specifike përfshijnë aftësimin e ekipeve të angazhimit për të kuptuar dhe përmbushur përgjegjësitë e tyre në lidhje me angazhimet duke theksuar se të gjithë anëtarët e ekipit të angazhimit janë përgjegjës për të kontribuar në manaxhimin dhe arritjen e cilësisë në nivel angazhimit; Ata:

- Sigurohen që anëtarët e ekipit të angazhimit kanë respektuar kërkesat etike të RSM Albania në lidhje me angazhimin dhe të qëndrojnë vigjilentë për çdo tregues të mospërputhjes me këto kërkesa gjatë gjithë periudhës së kryerjes së angazhimit;

kryer vlerësimin e zhvillimit profesional dhe identifikuar aspektet e nevojshme për përmirësim. Gjithashtu manaxherët dhe partnerët tanë, përditësohen vazhdimisht me ndryshimet më të reja, me qëllim ruajtjen e cilësisë sa më të lartë në ofrimin e shërbimeve. Në kulturën e punës tonë, konsultimi në grup, njihet si pikë e fortë dhe ne nxisim punonjësit që të konsultohen për çështje të vështira ose që kërkojnë diskutim. Keto konsultime përmirësojnë procesin e mësimin dhe zhvillimit të stafit, duke krijuar vlerë në njohuritë e përbashkëta, kontrollin e cilësisë dhe aftësive profesionale.

- Sigurohen që kërkesat e pavarësisë së RSM Albania të zbatueshme për angazhimin janë respektuar nga të gjithë anëtarët e ekipit të angazhimit dhe konkluzionet mbi pajtueshmërinë me kërkesat e pavarësisë janë të dokumentuara.
- Vlerësojnë efektin e çdo kërcënimi të identifikuar ndaj pavarësisë për të përcaktuar nëse ato krijojnë kërcënime për pavarësinë në angazhim;
- Ndërmarrin veprime të duhura për të eliminuar çdo kërcënim të tillë ose për t'i reduktuar ato në një nivel të pranueshëm; dhe
- Njoftojnë drejtuesin e Etikës dhe Pavarësisë për çdo shkelje të identifikuar të politikave të RSM Albania, dhe për veprime të mëtejshme që duhen ndërmarrë.
- Sigurohen që janë ndjekur procedurat e duhura dhe janë dokumentuar përfundimet në lidhje me pranimin ose vazhdimësinë e angazhimit;
- Sigurohen që ekipi i angazhimit ka kompetencat dhe përvojën e duhur, duke përfshirë dhënien e kohës së mjaftueshme për të kryer një angazhim cilësor në vazhdimësi;

- Inkurajojnë komunikimin e hapur dhe të vazhdueshëm brenda ekipit të angazhimit dhe mbështetësin anëtarët e ekipit të angazhimit në ngritjen e shqetësimeve pa pasur frikë nga hakmarrja;
- Sigurohen që ekipi i angazhimit ushtron gjykimin e duhur profesional dhe kur është e zbatueshme për llojin e angazhimit, skepticizëm profesional;
- Sigurohen që një rishikues i cilësisë së angazhimit është caktuar në angazhim, në rastet kur kërkohet sipas politikës së RSM Albania;
- Zhvillojnë konsultimet e duhura gjatë angazhimit, në rastet kur kërkohet sipas politikës së RSM Albania;

- Rishikojnë punën e kryer, për t'u siguruar që ajo është në përputhje me standardet profesionale të aplikueshme, kërkesat rregullatore dhe ligjore dhe mbështet konkluzionet e arritura;
- Sigurojnë që raporti ose materialet e tjera të leshuara janë në përputhje me kushtet e angazhimit dhe punës së kryer, dhe në përputhje me çdo politikë shtesë që mund kërkohet krahas kërkesave të ndërmarra nga RSM Albania.
- Vlerësojnë nëse ndonjë mangësi që ka lindur nga procesi i fundit i monitorimit dhe inspektimit ka ndonjë efekt në angazhim.


Mbikëqyrja dhe rishikimi

RSM Albania sigurohet që të gjitha angazhimet e shërbimeve profesionale të mbikëqyren siç duhet.

Politikat dhe procedurat e rishikimit të RSM Albania përcaktohen mbi bazën që puna e anëtarëve të ekipit të angazhimit me më pak përvojë rishikohet nga anëtarë me përvojë të ekipit të angazhimit.

Rrethanat në të cilat kryhen rishikimet e cilësisë së angazhimit përcaktohen nga çdo linjë shërbimi.

RSM Albania merr në konsideratë dhe përcakton çdo kriter të mëtejshëm ndaj të cilit duhet të vlerësohen të gjitha angazhimet e tjera për të përcaktuar nëse duhet të kryhet një rishikim i cilësisë së angazhimit.



Aktivitetet për vlerësimin dhe monitorimin e cilësisë

RSM Albania ka krijuar një proces monitorimi për të marrë siguri të arsyeshme që politikat dhe procedurat që lidhen me sistemin e kontrollit të cilësisë, mbi ofrimin e shërbimeve të sigurisë dhe shërbimet e tjera profesionale janë të përshtatshme, të duhura, funksionojnë në mënyrë efektive dhe janë në përputhje, me pritshmëritë e RSM dhe të gjitha kërkesat e zbatueshme të përcaktuara në standardet e vendosura nga Bordet e Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK), duke përfshirë:

- Standardin Ndërkombëtar për Kontrollin e Cilësisë (ISQC) 1, Kontrolli i Cilësisë për Firmat që Kryejnë Auditime dhe Rishikime të Pasqyrave Financiare, dhe Angazhime të Tjera të Dhënies së Sigurisë dhe Shërbimeve të Lidhura.
- Standardi Ndërkombëtar i Auditimit (SNA) 220, Kontrolli i Cilësisë për një Auditim të Pasqyrave Financiare
- Kodi Ndërkombëtar i Etikës për Profesionistët Kontabël (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë)

RSM Albania angazhon për të gjitha auditimet e shoqërive me interes publik, një partner si rishikues të kontrollit të cilësisë, i cili rishikon angazhimin para lëshimit të opinionit. Një rishikues i kontrollit të cilësisë, gjithashtu është pjesë e ekipit, për ato klientë

Konsultimet

Partneri i angazhimit duhet të sigurohet që ekipi i angazhimit të ketë ndërmarrë konsultimet e duhura gjatë rrjedhës së angazhimit. Çdo anëtar i ekipit të angazhimit mund të kërkojë një konsultim. Këshilluesit duhet t'i sigurohen të gjitha faktet për t'i lejuar ata të japin këshillat e duhura. Partneri i angazhimit duhet të sigurohet që çështja për të cilën është kërkuar konsultimi dhe rezultatet e konsultimit - duke përfshirë vendimet e marra, bazën e tyre dhe mënyrën se si janë zbatuar ato vendime - janë plotësisht të dokumentuara dhe të rëna dakord me personin(at) e konsultuar.

që konsiderohen kompleks apo gjykohet e nevojshme nga rrethanat.

RSM Albania është objekt i programit të inspektimit global të RSM International, të paktën një herë në tre vjet.

Objektivat e mëtejshme të kontrollit janë të japin një vlerësim të:

- Masës së përafrimit të RSM Albania me politikat dhe procedurat e RSM
- Aderimit të RSM Albania ndaj kërkesave ligjore dhe rregullatore lokale të zbatueshme
- Nëse sistemi i kontrollit të cilësisë së firmës është projektuar dhe zbatuar në mënyrë të përshtatshme, në mënyrë që raportet që lëshohen nga firma ose partnerët e angazhimit janë të përshtatshme me rrethanat
- Zonat/fushat ku nevojiten veprime të mëtejshme ose nga RSM Albania ose RSM për të ndërmarrë veprime korrigjuese ose për të bërë përmirësime në sistemin e kontrollit të cilësisë së Firmës

Një përfitim i veçantë i procesit të inspektimit është që ai ofron mundësinë për të identifikuar fushat për përmirësim në manaxhimin e angazhimit dhe në ofrimin e shërbimit ndaj klientit.



RSM Albania mund të kërkojë ndihmë nga personat që zotërojnë njohuri dhe ekspertizë të specializuar sa herë që hasin në situata ku mungon njohuria dhe përvoja e mjaftueshme dhe në disa situata specifike të përcaktuara nga politikat e RSM Albania.

Kur ekspertiza e kërkuar nuk disponohet së brendshmi, RSM Albania i drejtohet firmave të tjera të rrjetit RSM.

DEKLARATA E PAVARËSISË

Ne jemi të pavarur nga klientët tanë në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (duke përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK.

INFORMACION FINANCIAR

Të ardhurat e shoqërisë të realizuara gjatë vitit 2022 analizohen si më poshtë:

Të ardhurat	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 (në mijë lekë)
Të ardhura nga shërbime auditimi	17,741
Të ardhura nga shërbime të tjera	24,508

SHPËRBLIMI I PARTNERËVE

Shpërblimet e partnerëve bazohen në pagat dhe shpërndarjet e fitimit, sipas përqindjes së zotëruar në shoqëri.

LISTA E NJËSIVE ME INTERES PUBLIK (NIP)

NIP janë shoqëritë e përcaktuara në Ligjin Nr. 10 091 datë 5.03.2009, "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar", të ndryshuar.

- të gjitha njësitë ekonomike të listuara në bursë;
- bankat dhe degët e bankave të huaja, si dhe subjektet e tjera financiare jobanka, të licencuara nga Banka e Shqipërisë;
- shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit, shoqëritë administruese të fondeve të

investimeve kolektive, shoqëritë administruese të fondeve të pensionit vullnetar;

- shoqëritë e tjera shtetërore ose private, të cilat janë të rëndësishme për interesin e publikut, për shkak të natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Gjatë vitit 2022 Shoqëria ka audituar pasqyrat financiare të vitit të mbyllur në 31 dhjetor 2021, të shoqërive NIP si më poshtë:

Shoqëria	Industria	Për vitin e mbyllur më
ADTN sha	Telekomunikacion	31 dhjetor 2021
Alb-Progress shkk	Shërbime financiare, jo bankë	31 dhjetor 2021
Albcredit shkk	Shërbime financiare, jo bankë	31 dhjetor 2021
Digit Alb sha	Platforme televizive	31 dhjetor 2021
Easypay shpk	Shërbime financiare, jo bankë	31 dhjetor 2021
Euro Balkans News shpk	Media	31 dhjetor 2021
Evita shpk	Industri farmaceutike	31 dhjetor 2021
Hekurudha Shqiptare sha	Transport	31 dhjetor 2021
Le Spot Group sha	Marketing	31 dhjetor 2021
Micro Credit Albania shpk	Shërbime financiare, jo bankë	31 dhjetor 2021
RPAY shpk	Shërbime financiare, jo bankë	31 dhjetor 2021
Tirana Capital Trade shpk	Shërbime financiare, jo bankë	31 dhjetor 2021
DPSHTRR	Shërbime të transportit rrugor	31 dhjetor 2021
Enti Rregullator i Energjisë	Regullator në tregtimin e energjisë dhe gazit	31 dhjetor 2021
Pc Security shpk	Shërbime të ruajtjes fizike	31 dhjetor 2021
Final shpk	Shërbime financiare, jo bankë	31 dhjetor 2021
TID shpk	Ndërtim, Qira, Shitje energji elektrike	31 dhjetor 2021
Sani Service shpk	Shërbime dhe Tregti në fushën mjekësore	31 dhjetor 2021

